



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E GJAKOVËS
OSNOVNI SUD GJAKOVA – BASIC COURT OF GJAKOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

AGJ.I.nr. 57/2023

Datë 10.03.2023

Në bazë të nenit 14 të Ligjit për Gjykatat (nr. 06/L-054), Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenit 11 par. 1, 3, 7 dhe 12, si dhe nenit 17 par. 1, 3, 4, 5, 6 të Rregullores mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave, si dhe planit vjetor të punës së Gjykatës Themelore në Gjakovë me dy degët në Rahovec dhe Malishevë, kryetari i Gjykatës Nikollë Komani, pas marrjes së propozimit të kolegjiut të kësaj Gjykate, me datën 10.03.2023 përcakton:

**PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËVE TË GJYQTARËVE
DHE ADMINISTRATËS SË GJYKATËS THEMELORE NË GJAKOVË DHE DY DEGËVE
NË RAHOVEC DHE MALISHEVË**

Neni 1

Kryetari i Gjykatës, bazuar në kompetencat ligjore që ka për organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës, si rezultat i ndryshimeve që kanë ndodhur pas hartimit të planit vjetor të punës së Gjykatës Themelore në Gjakovë me dy degët e saja, e kjo si rezultat i vendimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ku gjyqtarët Dardan Hoxha dhe Shaqir Mazreku, janë transferuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, si dhe faktin që gjyqtarja Diana Sina, me datë 27.03.2023 dhe gjyqtarja Manduhije Sylja, me datë 05.04.2023 e arrin moshën e pensionimit, është paraqitur si domosdoshmëri riorganizimi i punës së Gjykatës me dy degët e saj. Andaj bazuar në kompetencat ligjore ka thirrur kolegjiutin e Gjykatës Themelore në Gjakovë me dy degët e saj, për plotësimin dhe ndryshimin e raporteve të punës.

Neni 2

2.1. Në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë, pas vendimit të KGJK-së për transferimin e gjyqtarit Shaqir Mazreku, me lëndët e natyrës së kundërvajtjes me të cilat ka qenë i ngarkuar gjyqtari Mazreku, do të ngarkohen dhe në mënyrë të barabartë do të ju shpërndahen gjyqtareve Njazi Morina dhe Lulzim Paqarizi, të cilëve edhe lëndët e reja të natyrës së kundërvajtjes do të i'u caktohen përmes programit të SMILI-it. Pra gjyqtaret Njazi Morina dhe Lulzim Paqarizi, do t'i trajtojnë dhe do të ngarkohen me lëndë penale dhe të kundërvajtjes.

2.2. Gjyqtari Lulzim Paqarizi, do të ngarkohet edhe me ekzekutimin e lëndëve të kundërvajtjes.

Neni 3

3.1 Në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, pas vendimit të KGJK-së për transferimin e gjyqtarit Dardan Hoxha, i cili ka qenë i ngarkuar me lëndë penale, civile dhe të kundërvajtjes, me lëndët penale dhe të kundërvajtjes do të ngarkohet gjyqtari Mizahir Shabani, ndërsa me lëndët civile do të ngarkohet gjyqtari Berkan Hamza.

3.2 Me ekzekutimin e lëndëve të kundërvajtjes do të ngarkohet gjyqtari Mizahir Shabani, si dhe sipas nevojës do të ngarkohet edhe gjyqtari mbikëqyrës Betim Behluli.

3.3 Bazuar në numrin e lëndëve penale me të cilët janë të ngarkuar dy gjyqtarët në Degën në Malishevë, gjyqtari Lulzim Paqarizi do të ngarkohet edhe me lëndë penale në Degën në Rahovec, si dhe do të angazhohet në trupa gjykues në Departamentin për Krime të Rënda.

3.4 Me lëndët e procedurës paraprake në Degën në Rahovec, do të ngarkohet gjyqtari Berkan Hamza, si dhe sipas nevojës edhe gjyqtari Mizahir Shabani.

Neni 4

4.1 Meqenëse gjyqtarja Diana Sina, do të pensionohet me datë 27.03.2023 është përcaktuar që me lëndët penale me të cilat ka qenë e ngarkuar gjyqtarja Sina, do të ngarkohet gjyqtari Samedin Cena, mirëpo pasi që i njëjtë akoma vijon pjesën praktike të trajnimit, deri sa gjyqtari ti plotëson kushtet ligjore për tu ngarkuar me lëndë, për trajtimin e lëndëve penale do të angazhohet gjyqtari Njazi Morina.

4.2 Po ashtu gjyqtarët e Departamentit të Krimeve të Rënda, sipas nevojës do të ngarkohen me lëndë penale të Departamentit të Përgjithshëm, si dhe me procedurat paraprake në këtë Departament.

Neni 5

Pasi që gjyqtarja Manduhije Sylja, gjatë muajit prill do të arrin moshën e pensionimit atëherë me lëndët e kundërvajtjes me të cilat ka qenë e ngarkuar gjyqtarja Sylja, do të ngarkohet gjyqtarja Myfera Hoxha.

Neni 6

Ky plotësim ndryshim i planit vjetor të punës është pjesë përbërëse e planit vjetor të punës së Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe dy degëve në Rahovec dhe Malishevë, AGJ.I nr. 290/2022 të datës 27.12.2022, i cili plan në pjesën që nuk është ndryshuar mbetet në fuqi.

Neni 7

Me këtë ndryshim të planit të punës njoftohet Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

